

V E N D I M
Nr.124, datë 27.2.1995

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.329, DATË
30.6.1993 “PËR KRIJIMIN E INSPEKTORATIT RAJONAL TË NDIHMËS DHE
PËRKUJDESJES SHOQËRORE”**

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 “Për ndihmën dhe përkujdesin shoqëror” me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.329, datë 30.6.1993 , bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, në paragrafin e parë hiqen fjalët “disa rrethe”.
 2. Në pikën 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Të verifikojë të dhënat e komunave dhe bashkive dhe të kryejë analiza studimore për nivelin e varfërisë së komunave, të bashkive e prefekturave”.
 3. Në pikën 3 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Në organikën e personalit të administratës shtetërore të ndihmës ekonomike dhe mbrojtjes shoqërore shtohen edhe 36 punonjës të tjerë. Pagat e inspektorëve të ndihmës ekonomike dhe mbrojtjes shoqërore njësohen me pagat e punonjësve të administratës shtetërore të punës”.
 4. Efekti financiar për 2.598.048 lekë përballohet nga buxheti i shtetit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi